



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 29 qershor 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ramiz Lladrovci, Murselj Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Munguan: Ali Sadriu dhe Muhamet Mustafa.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm,

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatore, KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi dhe Arta Demolli- praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ramiz Lladrovci – zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 15.06.2011,
4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – Propozoi që në rend dite të përfshihet edhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22 qershor 2011, meqenëse ky procesverbal është shpërndarë me kohë me email për anëtarët e Komisionit.

Rendi i ditës u miratua me propozimin e kryesuesit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 15.06.2011 dhe 22.06.2011

Armend Zemaj – Tha se në procesverbalin e datës 15 qershor 2011, në diskutimin tij fq. 5 pas fjalës “auditimit” të shtohet fjalia “të fondit të privatizimit” pastaj, pas fjalës auditori të shtohet fjalia “thotë” si dhe te fjalia “AKP ka shkuar me anë të negociatave të drejtpërdrejta” të shtohet fjalia “cila është mbështetja ligjore e AKP-së për zbatimin e këtyre procedurave”. Te procesverbali i datës 22 qershor 2011, fq 4 pas fjalës “ligj” të shtohet fjalia “për qeverinë”.

Murselj Haljilji – Në diskutimin tij “ndoshta çmimi do të ishte dhe më i vogël, mirëpo procesi do të ishte i ligjshëm”, do të duhej të ishte “ndoshta çmimi do të ishte më i ulët po të ishte tenderuar, por gjithsesi procesi do të ishte i ligjshëm”. Si dhe fjalia “nuk është transparencë nëse lajmërohen institucionet, por nëse procesi kryhet sipas ligjit”, do të duhej të ishte “nuk është transparencë nëse informohen institucionet siç është Presidenti i Kosovës, Qeveria, Institucionet Ndërkombëtare, por transparencë është nëse zbatohen procedurat ligjore rreth tenderimit, shpalljes, procesverbalit të hapjes, çka unë nënkuptoj me transparencë të këtij procesi”.

Valbona Dibra- Tha se rekomandimi që ka të bëjë me Fondin e Privatizimit është i paqartë, sepse është përfshirë vetëm rekomandimi për ZAP-in për kryerjen e auditimit të performancës së Fondit të Privatizimit. Kjo duhet të qartësohet, pasi që Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Fondit të Privatizimit nuk duhet të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare, përderisa nuk kryhet edhe auditimi i performancës nga ZAP-i. Propozoi që për këtë Komisioni të deklarohet me votim.

Kryesuesi - Ftoi anëtarët e Komisionit që me ngritje dore të deklarohen për propozimin - Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Fondit të Privatizimit të mos procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

Kryesuesi konstatoi se me katër vota “kundër” një “për” dhe dy “abstenime”, Raporti i auditimit të pasqyrave financiar të Fondit të Privatizimit nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me datë 15 qershor 2011 dhe 22 qershor 2011 me vërejtjet e deputetëve Armend Zemaj, Murselj Haljilji dhe Valbona Dibra.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010

Kryesuesi – Tha se raporti vjetor i performancës së ZAP-it është proceduar me kohë, mirëpo shqyrtimi i tij është shtyrë derisa në Kuvend të procedohen pasqyrat e audituara financiare. Pyeti: pse nuk janë bërë më shumë auditime të performancës? Në çfarë mase janë adresuar rekomandimet e ZAP-it nga entitete e audituara? Me rastin e binjakëzimit me zyrat e auditimit të Mbretërisë së Bashkuar, Sllovenisë dhe Holandës cilat projekte janë zhvilluar, në çfarë drejtimi po shkon ZAP dhe cilat objektivat dhe përfitimet e këtij binjakëzimi? Te paragrafi ku thuhet kemi futur mjete te ndryshme menaxhimi dhe administrative ta sqaroni këtë se çka keni menduar? Çka nënkuptoni me pavarësinë dhe kush mendoni se ka qenë pengesë në pavarësinë e ZAP-it pse është bërë një vlerësim i tillë në raportin e progresit. ZAP deri më tani nuk ka ngritur asnjë shqetësim lidhur me atë se ZAP është penguar në punën e tij dhe i cili ka cenuar pavarësinë e ZAP-it. Të gjitha raportet e ZAP-it kanë prezantuar se auditimi është bërë në bazë të standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI, ndërsa në raportin e performancës thuhet se për shkak të mënyrë se si janë formuluar rekomandimet e ZAP-it në një mënyrë që nuk janë në harmoni me standardet INTOSAI. Një mënyrë e cila nuk ishte në pajtim të plotë standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë, si rezultat i kësaj ZAP pranon se rekomandimet e tij nuk janë trajtuar nga menaxhmenti i lartë i entiteteve të audituara çka ka ndikuar në normën e ulët të ndërmarrjes së veprimeve mbi rekomandimet e ZAP-it. Kur saktësisht ZAP-i ka filluar të bëjë auditime të entiteteve buxhetore sipas standardeve ndërkombëtare INTOSAI? Çka nënkuptoni me atë se

ZAP do të kryej auditime të rregullsisë së Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe gjithashtu ZAP do të kryej edhe auditime të performancës që është në fushën e ZAP-it por që nuk është e obligueshme me ligj. Çka e pengon ZAP-in që të parashoh edhe auditime të performancës? Zyra kombëtare e auditimit të Suedisë së bashkëpunim e USAID do të bëjë vlerësimin e punës së ZAP-it. Cilat janë të gjeturat e këtij auditimi? Kërkesën e ZAP-it për rritje të stafit dhe të buxhetit ashtu siç edhe ka kërkuar ZAP-i, është aprovuar dhe qeveria e ka miratuar. ZAP ka shprehur shqetësimin se proceset aktuale nuk janë të dizajnuara mirë dhe praktikat lënë vend për përmirësim. Çka ka kërkuar ZAP nga Komisioni e që nuk është miratuar? Cili është shqetësimi i ZAP-it dhe çka duhet të bëjë Komisioni për të evituar këtë shqetësim të ZAP-it. Kuvendi ka miratuar kërkesat e ZAP-it për rritje të numrit të stafit, ndërkohë në raport akoma figurojnë të dhënat se auditimet janë kryer nga firma private. Pse ndodh kjo dhe cili ka qenë kriteri i përzgjedhjes së këtyre firmave dhe i kostos së auditimit? Mesatarja e një auditimi nga 3040 euro për vitin 2007/2008, 4804 euro për vitin 2008/2009, 488euro për vitin 2009/2010, ndërsa për vitin 2010/2011 një ngritje enorme mesatarja prej 6153 euro për një auditim. Cili është rekomandimi i ZAP-it për Komunën e cila nuk ka prodhuar pasqyra vjetore financiare dhe ka refuzuar auditimin? A ka paraqitura ZAP-i të hyrat nga auditimi i projektit ndërkombëtar DANIDA, dhe a kanë hyrë në Buxhetin e Kosovës? Sa auditorë janë trajnuar përmes shoqatës së kontabilistëve dhe auditorëve të certifikuar të Serbisë? ZAP ka dërguar katër pjesëtarë të komuniteteve për trajnim dhe certifikim në këtë shoqatë dhe nuk kanë kaluar certifikimin. A është fjala se këta nuk kanë arritur të marrin njohuritë e duhura dhe kanë dështuar po ka qenë vendim politik i shoqatës që të mos i kaloj me qëllim që auditimi në entitetet buxhetore të jetë i pamundur dhe pse duhet të vazhdohet bashkëpunimi me këtë shoqatë përderisa nuk certifikojnë këta njerëz? Sa ditë, ore, dhe sa persona ka trajnuar shoqata e kontabilistëve të Serbisë dhe cila ka qenë kostoja e këtij trajnimit. Në sa raste ZAP-i ka marrë përgjigje nga institucionet kompetente për llogaridhënie – është fjala për rastet kur ZAP-i ka ngritur “*flamurin e kuq*”. A ka bërë ZAP kërkesë që të jetë pjese e INTOSA-it edhe EUROSIA-it? A ka ZAP-i strategji dhe çka e ka penguar ZAP-in që të marrë pjesë në këto dy organizata.

Auditori i jashtëm që ka bërë auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2010, ka ngritur disa shqetësime si: pagesat në rastin e angazhimit të dy personave për përkthime janë bërë në llogaritë personale të tyre. Pse është lejuar një gjë e tillë dhe çfarë masash janë ndërmarrë ndaj menaxherit të prokurimit? Pastaj mungesa e deklaratës nën betim të operatorit ekonomik? A ka arritur ZAP që të mbajë dosje të azhurnuara të personelit - domethënë dosjet të përmbajnë dokumentet relevante? Pastaj rekomandimi që ka të bëjë me numërimin fizik të aseteve fikse dhe stokeve të barazohen me shënimet e kontabilitetit duhet të zbatohet nga ZAP-i.

Valbona Dibra – Raporti i ZAP-it është shumë përmbajtjesorë dhe profesional. Është një prej raporteve vjetore më të mira. Pyeti: në çfarë aspekti ka paraparë ndryshimin e kornizës. A është fjala për kornizës ligjore? Parashihet që ZAP të ketë të hyra gjatë auditimit të fondeve, por kjo nuk është përfshirë në pasqyrat financiare. Me mbulimin e auditimit në të hyra jemi të kënaqur, por te shpenzimet, çka është pengesë që nuk është mbuluar i gjithë auditimi i OB. Realizimi i buxhetit të zyrës është i kënaqshëm, mirëpo sipas raportit 52% e burimeve janë shpenzuar për kompensime - paga, atëherë shihet se buxheti nuk është shpenzuar në proporcion. Përqindja e strukturës së gjinisë femërore është rritë- inkurajoi ZAP-in që të vazhdoj me këtë. Është shqetësues fakti që vetëm tre auditor janë duke kryer trajnime për auditim të performancës. Ku qëndron problemi? Edhe pse Kosova nuk është e anëtarësuar në Kombet e Bashkuara, kur mund të presim një anëtarësim në INTOSAI dhe EUROSIAI.

Afrim Hoti - Tha se rritja e numrit të auditorëve në të ardhmen do të ishte shumë i drejtë në parandalimin në keqmenaxhimin e parasë publike. Në raport nuk është përfshirë se përse ZAP-i nuk ka kaluar ende në objektin e Administratës Tatimore të Kosovës ashtu siç ishte parashikuar që deri më datë 15 dhjetor 2009 kjo zyrë të zhvendosej dhe mjetet që paguhen për qira dhe shpenzime të tjera të përdorshin për rritjen e efektshëmerisë së ZAP-it.

Mursel Haljilji – Nga raporti shihet se është bërë një punë mjaftë serioze dhe një numër i mjaftueshëm i të dhënave flasin se është bërë një punë shumë e rëndësishme për vitin 2010.

Pyeti: auditori i përgjithshëm, a është i kënaqur me punën e tij? Sipas raportit rekomandimet e ZAP-it nuk implementohen, kjo është shumë shqetësuese, dhe njëra nga shkaqet është se rekomandimet nuk janë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit. A do të aplikohen këto standarde ndërkombëtare? Sepse auditimi nuk do të jetë i mirë nëse rekomandimet nuk zbatohen. Cilat janë mekanizmat për t'u respektuar këto rekomandime? Cilat janë mjetet tjera për përmirësimin dhe zbatimin e këtyre rekomandimeve?

Albert Kinolli – Pyeti: sa është i kënaqur auditori i përgjithshëm me ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore? Në tabelë shihet se janë punësuar katër serb dhe një të tjerë. Pyeti: çka po ndodh me komunitetet e tjera si dhe rubrika komunitetet të tjera pyes çka përfaqëson kjo të tjerë?

Armend Zemaj –Raporti tregon se ka një progres të vazhdueshëm prej viti në vit. Por në çdo organizatë janë disa çështje pothuajse të imta dhe nuk po tejkalohen p.sh zbatueshmëria e rekomandimeve, rregullsia në burime njerëzore si: dokumentacioni, pastaj asetet fikse dhe stoqet. Ndoshta në të ardhmen ZAP-i duhet të fokusohet te auditimet në komuna, sepse Kuvendit i interesojnë grandet që fitojnë komunat nga niveli qendrorë. Është shqetësuese interferimi i politikës në ZAP. Dhe kur ZAP-i kërkon që entitetet si Kuvendi, Qeveria dhe Gjyqësori të hapin rrugën për një shërbim publik më të mirë, tregon se ZAP-i ka pas problemeve në raport me Qeverinë, Kuvendin dhe Gjyqësorin në hartimin e raporteve dhe prezantimin e të gjeturave në OB. Sa ka ndikim politika në ZAP dhe çka mund të bëjë Kuvendi përkatësisht komisioni në interferimin e asaj që quhet respektim i ligjit dhe në drejtim të asaj që politika të jetë larg ZAP-it dhe auditorëve që bëjnë auditimin në OB.

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm - Auditimin e pasqyrave vjetore financiare për vitin 2010 e ka bërë BDO dhe ata kanë adresuar disa gabime shumë të vogla. Sa i përket tarifës prej 3000 euro nga auditimi i projektit DANIDA - këto të hyra janë të shpaluara, por nuk janë paraqitur ne pasqyrat financiare për arsye se këto të hyra shkojnë direkt në Buxhetin e Kosovës që do të thotë se nuk janë fonde të ZAP-it. Mementalisht ne kemi 92 institucione që ju keni thënë në ligjin e juaj të buxhetit që këto institucione duhet të përgadisnin pasqyra vjetore financiare përveç atyre që janë të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Organizatat buxhetore të cilat përgatisin pasqyrat vjetore financiare duhet të kenë auditim. Për të kryer këtë numër të auditimeve është një sfidë, por kjo është e detyrueshme dhe duhet të bëhet çdo vit. Kryerja e auditimeve të performancës është e drejtë, nuk është diçka e detyrueshme, pastaj kryerja e auditimeve menaxheriale është një e drejtë nuk është diçka e detyrueshme. Së pari duhet të sigurohem se mund të përfundojmë këto auditime të rregullsisë në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit të cilat janë ndryshuar vitin e kaluar dhe në të njëjtën kohë të forcojë aftësitë e auditorëve për të kryer auditime tjera. ZAP është duke u munduar që të forcojë këtë në mënyrë të vazhdueshme në pajtim me strategjinë e zhvillimit të përbashkët. ZAP është duke blerë shërbimet nga Shoqata e Kontabilistëve të Kosovës, kjo fokusohet në sektorin privat dhe nuk i adresojnë specifikat e sektorit publik dhe së bashku me Ministrin e Financave është duke punuar që të ketë një regjim ku mund për auditor të certifikuar publik të cilët janë të fokusuar në sektorin publik, për të shkuar përmes certifikimit të SKAK-ut janë diku 12 provime, 3 faza dhe merr më së paku 3 vite dhe për secilin person kushton diku rreth 2600 euro. Mangësia e SKAK-ut është se ata nuk po ofrojnë trajnime në gjuhën serbe dhe për shkak të kësaj është bërë marrëveshja me një organizatë në Beograd. Staf serb janë vetëm 4 dhe është shumë problem në sjelljen e komuniteteve në ZAP. Serbët të cilët shkojnë në Beograd janë duke i kryer provimet po aq mirë sa edhe auditorët e tjerë, i kanë kaluar disa provime gjatë një viti të gjysmë, anëtarë i pestë i komunitetit është një goran dhe ai është një prej zëvendësauditorëve të përgjithshëm një figurë premtuese për të ardhmen. Tani janë duke i rekrutuar diku rreth 12 anëtarë të ri të stafit dhe janë disa kandidat serb, por një tani është tërhequr për shkak se nuk është në gjendje të punoj për këtë zyrë. Çështja e barazisë gjinore krahasuar me çështjen e komuniteteve është shumë pozitive dhe tani sfidë është që para se të riorganizohet zyra para sezonit të ri të auditimit është që të kemi më shumë pozita menaxheriale. Masa që ndërliiden se sa janë adresuar rekomandimet tona nuk kemi qenë të kënaqur me këtë ne tani jemi veç duke e finalizuar sezonin e auditimit gjendja është pak më e mirë. Në këtë drejtim kanë ndihmuar auditimet e ndërmjetme po ashtu

edhe shëndetësore, pastaj Udhëzimi Administrative i Qeverisë për pasqyrat vjetore financiare do të publikohet në fund të vitit dhe kjo do i jep shpenzuesve buxhetor më shumë kohë për të kuptuar kërkesat për raportim ndërsa kjo do t'i shërbejë ZAP-it si një input për auditim. Komunitatet do të jenë të detyrueshme që të përgatisin pasqyrat vjetore financiare në fund të shtatorit dhe do të auditohen këto pasqyra financiare nëntë mujorsh. ZAP do të jap këshilla se si të përgaditen pasqyrat vjetore financiare. Qeveria ka përfunduar një vetëvlerësim për çështjen e kontrollit ku të gjithë shpenzuesit buxhetor duhet të shkojnë përmes kësaj.

Pavarësia e Zyrës - korniza ligjore për auditorin e përgjithshëm dhe zyrën e auditimit kërkon që të forcohet. Është mirë që auditori i ardhshëm i përgjithshëm duhet të ketë një mandat shtatë vjeçar për shkak se kjo e zvogëlon rrezikun për korrupsion. Duhet të sigurohet një mekanizëm që e paraqet një kufi të qartë në mes të Qeverisë dhe auditimit të jashtëm – kjo nuk ka të bëjë me përgatitjen e buxhetit por me implementimin e tij, parimet duhet të jenë të vendosura dhe nuk duhen të menaxhohen përmes Qeverisë, kjo është arsyeja pse pavarësia është një çështje për shqetësim në raportin e progresit dhe mënyra më e mirë për të marrë një mendim tjetër në raportin e progresit më e mira është që të adoptojmë një ligj të ri për zyrën e auditorit të përgjithshëm dhe auditimin në Kosovë dhe nëse është e mundur të bëjmë amandamente edhe në Kushtetutë. Vlerësimi i zyrës është bërë nga Zyra kombëtare e auditimit të Suedisë – konkludimet nga suedezët janë ende provuese por ata janë duke theksuar se ku jemi tani dhe se si duhet të punojmë me ata në të ardhmen aty ku më shumë është vërejtje që kemi nevojë është auditimi i performancës.

INTOSAI – Qëllimi është që të zhvillojë këtë institucion si institucionin më të mirë në të gjithë rajonin. Nuk mund të jemi anëtarë të INTOSAI para se Kosova të njihet nga Kombet e Bashkuara dhe kam bërë të pamundurën që së paku të kemi një status të vëzhguesve. Në kongresin e fundit të mbajtur më kanë ofruar mundësinë që të jem aty nën flamurin e tyre, e diskutova me presidentin atë kohë dhe kemi vendosur së bashku që nëse unë do të jem vëzhgues në atë kongres unë duhet të jem nën flamurin e Kosovës.

Ndërhyrjet politike - nuk ka ndërhyrje politike, mundë të ketë ndonjë ndërhyrje politike apo të klanit politik në punën kur janë auditorët në teren, por kjo është shumë vështirë të zbulojmë. Çdo vit me riorganizimin e zyrës, ndryshohen përgjegjësit në mënyrë që të zvogëlohet rrezikun për një marrëdhënie të ngushtë që zhvillohet përgjatë dy viteve.

Vitin e ardhshëm do të jenë diku 16 deri 18 auditime, jo 24 të kontraktuara në firma private në të njëjtën kohë pasi që jemi duke e zgjeruar fushën tonë të auditimit. Jemi duke i mbuluar pothuajse të gjithë shpenzuesit buxhetor të cilët përgatisin pasqyra vjetore financiare. Prej buxhetit të Kosovës është një vlerë e madhe e parasë që nuk është e ngulitur në shpenzues buxhetor sikurse Trusti, nuk është se ne e auditojmë atë, paratë i paguhen qeverisë dhe është jashtë fushës tonë dhe për këtë arsye ne jemi duke audituar më shumë të hyra se sa shpenzime sepse shpenzimet po shkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë te organizata.

Valbona Dibra - Do të thotë ZAP-i nuk ka audituar Trustin Pensional dhe kjo e ka zvogëluar përqindjen e mbulimit të auditimit të shpenzimeve?

Armend Zemaj – Trusti financohet nga taksa menaxhuese e cila është para e qytetarëve - taksapaguesve. Kur Komisioni të trajtoj çështjen e Trustit Pensional, duhet të shikohet për një auditim të performancës, sepse lidhet drejtpërdrejtë me taksat e qytetarëve dhe asnjëherë nuk kanë prezantuar menaxhimin e taksave. Kuvendi ende nuk e din se cilat janë pagat në Trustin Pensional.

Ramiz Lladrovci – Pyeti; nëse Ligji nuk lejon që ZAP-it të bëjë auditimin e Trustit Pensional atëherë çka duhet të ndërmarr Komisioni lidhur me këtë si dhe a ka staf profesional ZAP-i për të kryer këtë auditim?

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – Sipas Ligjit aktual, Kuvendi ka vendosur që auditimi i detyrueshëm i kësaj organizate duhet të bëhet nga një firmë private. ZAP ka të drejtën të bëjë forma të tjera të auditimit në këtë institucion dhe kjo është një prej gjërave që duhet të

forcohet kur do të amandamentohet ligji i Zyrës. Për auditimin e Trustit Pensional dhe të Bankës Qendrore duhet të punojë me një ekspertizë të specializuar në fushën e këtyre fondeve.

Ndërtesa e Administratës Tatimore të Kosovës - Qeveria ka vendosur që Administrata Tatimore e Kosovës duhet të qëndroj në atë ndërtesë, nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë hapësirë të re në pajtim me marrëveshjen që është arritur.

Lidhur me komunat, të gjitha 37 komunat tani kanë përgatitur pasqyrat vjetore financiare, kurse tri komunat e reja pasqyrat financiare janë përgatitur me ndihëm e Ministrisë së Financave dhe janë vonuar, këtë javë do të i keni të gjitha auditimet e komunave - 34 të publikuara dhe brenda dy jave do të publikohen tri të fundit. Pasqyrat vjetore financiare për këto tri komunat në veri janë raporte se si e kanë shfrytëzuar paratë e Buxhetit të Kosovës, nuk janë pasqyra vjetore financiare të cilat e mbulojnë të gjithë veprimtarinë e asaj komune dhe burime të tjera të financimit që ne në Kosovë nuk kemi kontroll për ato.

“Flamuj të e kuq” janë diku dhjetë, dhe ZAP nuk ka informata për rezultate. Dhe ajo e fundit, çka mund të prisni vitin e ardhshëm, më shumë auditime të rregullsisë po ashtu edhe auditime të performancës dhe mendoj që mund të prisni adresim më të mirë të rekomandimeve, sepse ZAP është duke dhënë rekomandime të mira dhe më të lehta për tu kuptuar.

Të gjitha komunat janë audituar, përveç kësaj kemi instaluar pasqyrat financiare nëntë mujore, por çështja më e rëndësishme është se ju keni vendosur në Ligjin për Borxhe Publike se nëse këto komuna nuk marrin opinion të pastër dy vite radhazi nuk mund të marrin kredi, dhe tani shumë projekte kanë filluar në Kosovë ku janë duke u munduar që të përmirësojnë mënyrën se si po shpenzohet energjia, spitalet dhe kjo nuk mund të përdoret nga komunat nëse nuk e kanë një opinion të pastër, kjo është një shtytje në vetvete që ne do ta përdorim që të kemi një menaxhim më të mirë financiar dhe një raportim të jashtëm më të mirë.

Afrim Hoti – Pyeti: nëse Auditori i përgjithshëm është ftuar ndonjëherë nga ministrat apo Kryeministri për të biseduar për raport të auditimit?

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm - Nuk kemi asnjë presion prej asnjë ministri, gjithmonë i diskutoj raportet e mija me ministra se çfarë ata duhet bërë. Ekziston një rast dy vite më parë dhe ky rast është diskutuar mjaftë në Komisionin për mbikëqyrje të financave publike në atë kohë dhe ka qenë raporti për RTK-në, ku ish komisioni për mbikëqyrje me këto keqkuptime - që ju duhet të apromoni raportet tona - komisioni në atë kohë nuk e ka aprovuar raportin tim për RTK-në për shkak të faktit se kanë thënë që bordi nuk ka punuar si duhet dhe gjithashtu kam pasur një rast kur për herë kam filluar me auditim ndërmarrjet publike ku këshilltarët ligjore janë munduar të më thonë se nuk e kam pasur këtë të drejtë për shkak të faktit se Ligji mbi ndërmarrjet publike i cili është adoptuar një javë më vonë pas Ligjit për zyrën e auditorit të përgjithshëm, mirëpo pas sqarimit se çka thuhet në Kushtetutë i ka hequr ndalesat dhe unë kam vazhduar me punë. Pastaj ka qenë auditimi që i është bërë Termokosit dhe është diskutuar mjaftë shumë, mirëpo këtë nuk e quaj presion.

Armend Zemaj – Propozoi që një nga rekomandimet për Kuvendin të jetë edhe fuqizimi i pavarësisë financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJ

1. *Të miratohet Raporti vjetor i performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm me pasqyrat vjetore financiare të audituara, për vitin 2010.*
2. *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të shikoj mundësitë për të shtuar numrin e auditimeve të performancës.*
3. *Të fuqizohet pavarësia financiare e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.*
4. *Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti Ramiz Lladrovci, zv.kryetar i parë i Komisionit.*

4. Të Ndryshme

a) Obligimet e Komisionit nga Plani i Veprimit i Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2011

Kryesuesi - Njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me obligimet e Komisionit që dalin nga Plani i Veprimit i Kuvendit për Integritet Evropian për vitin 2011. Komisioni ka ndërmarrë këto veprime: është në përfundim të mbikëqyrjes së Zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës. Raportet e ZAP-it procedohen në Komision sipas planit të proceduar në Komision, si dhe Komisioni ka organizuar një dëgjim parlamentar me ministrin e financave lidhur me funksionimin e NJQHA. Për pikat e tjera KMFP nuk është komision kryesor, por është si komision i dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zv.kryetari i parë i Komisionit

Ramiz Lladrovci